



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



IPKO Telecommunication  
Andras Pali  
Drejtor  
Prishtinë

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION  
22 -01- 2024  
Ref. 2401/126/KPM/jm

VENDIM

Lidhur me Rastin Nr. 2024/4 - Ankesat e qytetarëve (Palët ankuese) kundër  
Ipkos (Palë përgjegjëse)

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) ka miratuar Rregulloren KPM-2020/01 për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale, e cila ka hyrë në fuqi më 3 nëntor 2020. Me Rregulloren KPM-2020/01 janë përcaktuar rregullat dhe procedurat për shpërndarjen e ofruesve të shërbimeve mediale nga ana e operatorëve të shpërndarjes, të cilët pavarësisht teknologjisë së përdorur shpërndajnë përmbajtje audio dhe audiovizuale.
2. KPM ka pranuar një numër të madh të ankesave që nga data 1 janar 2024 ndaj Palës përgjegjëse, (deri me datën 18 janar 2024 gjithsej janë 23 ankesa) me pretendimin se Pala përgjegjëse ka hequr nga transmetimi kanalet e Digitalb pa paralajmërim paraprak. Palët ankuese në ankesat e tyre kanë shprehur shqetësimin për kontratën e lidhur me Palën përgjegjëse dhe problemet lidhur me mos zbatimin e saj, duke pretenduar se gjatë marrëveshjeve në mes të klientëve dhe Palës përgjegjëse nuk janë informuar me kohë se kanalet e Digitalb do të ndërpriten me 1 janar 2024. Palët ankuese janë ankuar edhe për ndërprerjen e kanaleve të sportit.
3. KPM, me qëllim të sqarimit të pretendimeve ankimore, me datën 4 janar 2024 përmes një shkrese e ka njoftuar Palën përgjegjëse për ankesat e pranura dhe ka kërkuar sqarim brenda tre (3) ditësh lidhur me pretendimet ankimore
4. KPM ka pranuar përgjigje nga Pala përgjegjëse, përmes të cilës ka theksuar se: "Ankesat e parashtruara ndërlidhen me shfrytëzimin e shërbimit fix "Max Mega", pako kjo e cila përmban shërbimin e internetit dhe të televizionit digjital. Siç është paraparë në kushtet e përdorimit të këtij shërbimi të drejtat e transmetimit për kanalet dhe ngjarjet e ofruara nga Ipko në platformë janë të drejta që kontraktohen për periudha të caktuara. Ipko gjatë negociimit të tyre, gjithmonë synon që t'i kontrakttoj të njëjtat për periudha sa më të gjata, mirëpo duke marrë parasysh karakterin dinamik të tyre, Ipko e ka të pamundur të garantoj që përmbajtja e platformës së vet do të jetë e pandryshueshme gjatë periudhës kontraktuale me përdoruesin. Lidhur me ndërprerjen e transmetimit të kanaleve të Super Sport dëshirojmë t'ju informojmë se këto kanale janë ndërprerë nga transmetimi nga ofruesi i përmbajtjes në këtë rast nga Artmotion pa njoftim paraprak. Si rezultat, ndërprerja e

*transmetimit nga ky ofrues është reflektuar automatikisht edhe në platformën tonë për çka konfirmojmë se ka qenë jashtë kontrollit tonë si operator.”*

5. KPM me datën 17 janar 2024 i ka dërguar edhe një shkresë Palës përgjegjëse me të cilën i ka kërkuar që të ofrojë si dëshmi listën e kanaleve të bashkangjitura në kontratën me përdoruesit, ashtu siç kërkohet me nenin 15, paragrafi 2, të Rregullores KPM-2020/01.
6. Pala përgjegjëse me datën 18 janar 2024 ka kthyer përgjigje duke theksuar se për shkak të pamundësisë për të garantuar që përmbajtja e platformës do të mbetet e pandryshueshme gjatë periudhës kontraktuale me përdoruesin, listën e kanaleve e publikon në faqen zyrtare, duke dështuar kështu të veprojë në pajtim me nenin 15, paragrafi 2, të Rregullores KPM-2020/01.
7. Gjithashtu, bazuar në të gjeturat e monitorimit vërehet se Pala përgjegjëse nuk e ka njoftuar KPM-në për ndryshimin e listës së kanaleve, ashtu siç përcaktohet me nenin 4, paragrafi 3, të Rregullores KPM-2020/01.
8. KPM, bazuar në Raportin e monitorimit të datës 11 janar 2024, ka konstatuar se Pala përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 15, paragrafi 2 dhe 5 si dhe nenin 4, paragrafi 3, të Rregullores KPM-2020/01 për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale.

#### Analiza ligjore

9. Komisioni i Pavarur i Mediave ankesat i ka trajtuar dhe analizuar në kuptim të Rregullores KPM-2020/01, përkatësisht bazuar në nenin 15, paragrafi 2 dhe 5 dhe nenin 4, paragrafi 3.
10. KPM, bazuar në Raportin e monitorimit ka konstatuar se Pala përgjegjëse ka dështuar të ndërmarrë veprimet e duhura në lidhje me mbrojtjen e përdoruesve, duke mos informuar përdoruesit me shkrim së paku tridhjetë (30) ditë para ndryshimeve të kushteve të shërbimeve, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 15, paragrafi 5, të Rregullores KPM-2020/01, i cili përcakton se:

*“I licencuari duhet t’i informojë përdoruesit me shkrim së paku tridhjetë (30) ditë para ndryshimeve në tarifat dhe kushtet tjera të shërbimeve.”*

11. KPM, bazuar në Raportin e monitorimit ka konstatuar se Pala përgjegjëse nuk ia ka bashkëngjitur çdo përdoruesi listën e kanaleve si pjesë e kontratës të lidhur me përdoruesit, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 15, paragrafi 2, të Rregullores KPM-2020/01, i cili përcakton se:

*“I licencuari duhet po ashtu t’i sigurojë çdo përdoruesi të ri listën e kanaleve për çdo shërbim të programit në dispozicion në sistemin e rrjetit, si pjesë e kontratës së shërbimit medial audio dhe audiovizuel.”*

12. KPM, bazuar në Raportin e monitorimit gjithashtu ka konstatuar se Pala përgjegjëse nuk e ka njoftuar KPM-në për ndryshimin e listës së kanaleve, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 4, paragrafi 3, të Rregullores KPM-2020/01, i cili përcakton se:

*"I licencuari obligohet që për çdo ndryshim të katalogut të ofruesve të shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale, si pjesë përbërëse e Licencës, ta njoftojë KPM-në."*


13. Prandaj, KPM duke u bazuar në faktet e lartpërmendura ka konstatuar se Pala përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 15, paragrafi 2 dhe 5 dhe nenin 4, paragrafi 3, të Rregullores KPM-2020/01.

### Vendim

14. Pala përgjegjëse sanksionohet me gjobë në shumën prej shtatë mijë (7.000) euro, në pajtim me nenin 30, paragrafi 1 pika 1.3, të Ligjit të KPM-së, për shkelje të nenit 15, paragrafi 2 dhe 5 dhe nenit 4, paragrafi 3, të Rregullores KPM-2020/01.
15. Sanksioni i shqiptuar nga KPM ka për qëllim dënimin administrativ të operatorit për shkeljen e Rregullores KPM-2020/01 dhe jo kompensimin e palëve ankuese, prandaj konsiderohet se një nivel i tillë i gjobës arrin efektin dhe qëllimin e dënimin.
16. Ky sanksion nuk paragjykon shkeljet eventuale të legjislacionit për mbrojtjen e konsumatorit, të cilat duhet adresuar përmes institucioneve kompetente.
17. Ky vendim mbetet në fuqi edhe për ankesat tjera që mund të vijën për çështje të vendosura me këtë vendim.
18. Pala përgjegjëse obligohet që gjobën në shumë prej shtatë mijë (7.000) euro e përcaktuar nga pika 14 e këtij vendimi, ta paguajë në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, në xhirollogarinë e KPM-së numër: 1000400070001635.
19. Në rast se pala përgjegjëse nuk e paguan gjobën brenda afatit të përcaktuar në pikën 18 të këtij vendimi, i njëjti kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme në procedurë përmbarimore.

### E drejta për ankesë

20. Ankesat i parashtrihen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
21. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.

  
Jeton Mehmeti  
Kryetar



19.01.2024  
Datë